

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA E PRESIDENTIT NATIONAL AUDIT OFFICE

Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No. 475
Date / Datum / Dat. 03.08.20
PRISHTINE A



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE PRANUAR DOREZUAR: 3 - 08 - 2020
DATE RECEIVED / DATE SUBMITTED:

Klasif. Org. Jedin. / Org. Unit	Shif. klasif. / Klasif. Kod / Class. Code	Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.	Nr. i faqëve / Br. Stranica / No. Pages
03	47	1359	2

REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PRESDENIKA

SEKRETARI I ZYRËS - SECRETARY OF THE OFFICE - SEKRETAR KANCELARIJE

DATE:	03.08.2020
PËR/ZA/TO:	Z. Besnik OSMANI, Auditor i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës (ZKA)
CC:	Z. Ardian ARIFAJ, Zëvendësues i Stafit të Kabinetit të Presidentit
NGA/OD/FROM:	Driton GASHI, Sekretar i Zyrës së Presidentit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani veprimi për implementim të rekomandimeve

Të nderuar,

Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës (ZPRK), me datë 24.07.2020, ka pranuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, raportin final, Pasqyrat Financiare Vjetore, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019.

Duke analizuar raportin final, së bashku me stafin menaxhues, kemi trajtuar të gjitha çështjet, përfshirë të gjeturat dhe rekomandimet. Janë marrë veprimet e menjëhershme në drejtim të adresimit, dhe njëherit, kemi projektuar edhe planin e veprimit për implementim të rekomandimeve.

ZPRK, bënë përpjekje të vazhduar në shtimin e veprimeve për funksionim dhe avancim të kontroleve të brendshme në të gjitha fushat, andaj zotohemi se do të bëjmë përpjekje në avancimin edhe të mëtejme të performancës së Zyrës së Presidentit duke marrë masa të reja organizative dhe mbikëqyrëse për eliminimin lëshimeve eventuale procedurale.

Në vijim mund ta shihni planin e veprimit që e kemi detajuar, në lidhje me adresimin dhe implementimin e rekomandimeve.

Rekomandimet	Angazhimi	Përgjegjësia	Aktiviteti/Implementimi	Afati
--------------	-----------	--------------	-------------------------	-------

Çështja A1	Detyrë permanente	Drejtori i DAB ZKF	Konsiderohet e kryer me që kishte të bënte me përvjetorin e 20 të çlirimit dhe të njëjtat raste do të shtohet kujdesi që të mos përsëriten gjatë lëndëve të zakonshme.	Rekomandim i zbatuar
Çështja B1	Detyrë permanente	Sekretari	Përkundër që me buxhetin e vitit 2020, Presidencës iu kanë shkurtuar pozitat e aprovuara dhe nuk do të ketë mundësi rekrutimi për pozita të rregullta të cilat mungojnë, do të bëhen përpjekje që deri në fund të vitit kontratat për shërbime të veçanta të zvoglohen dhe në rastet e domosdoshme angazhimet do të bëhen konform procedurave të parapara ligjore.	Viti fiskal
Çështja A2	Detyrë permanente	Komisioni për ndarjen e Subvencioneve	Komisioni për Subvencione do të vazhdojë të monitorojë raportimin e subvencioneve dhe rastet e mosraportimit do të adresohen tek organet kompetente gjyqësore.	Viti fiskal
Çështja A3	Detyrë permanente	Drejtori i Depart. të Administratës dhe Buxhetit	Drejtori i Depart. të Administratës dhe Buxhetit është duke propozuar Komisione të Pranimit të cilat themelohen në vazhdimësi me vendim të sekretarit	Rekomandim i zbatuar
Çështja B2	Detyrë permanente	Drejtori i NJAB	Kërkesa për angazhim të menjëhershëm për realizimin e planit auditues	Viti fiskal